



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive	
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	01 / 301
Data Datum Date:	24.03.2020
Prishtinë/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave dhe Transfereve
Ministarstvo za Financije i Transfere / Ministry of Finance and Transfers

Nr. 22 / 2020
Datë: 23.03.2020

Në mbështetje të nenit 8, paragrafi 1.4, të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, me qëllim të zbatimit të Vendimit Nr. 01/07 dhe 01/09 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për marrjen e masave shtesë pas konfirmimit të rasteve pozitive me Corona Virus COVID 19, Ministri i Financave dhe Transfereve merr këtë:

VENDIM

1. Lirohen përkohësisht nga pagesa e TVSH-së të gjitha importet e grurit dhe miellit, për prodhimin e bukës dhe produkteve të bukës.
2. Me këtë Vendim, me automatizëm, pa pasur nevojë për të parashtruar kërkesë të veçantë, lirohen përkohësisht nga taksa doganore dhe TVSH-ja të gjitha subjektet biznesore prodhuese apo kontraktuesit e tyre, që merren me importimin e lëndës së parë të specifikuar në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Obligohet Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.



Besnik Bislimi

Ministër i Financave dhe Transfereve

Vendimi i dërgohet:

- ATK-së;
- Departamentit të Politikave Fiskale; dhe
- Arkivit të Ministrisë;